



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
Nr. 21 datë 25.3.2021

**PËR DHËNIE DAKORTËSIE PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES
NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK PËR “AKTIVITET MINERAR TË
SHFRYTËZIMIT TË GURIT GËLQEROR PËR OBJEKTIN GAJTAN-GURI I ZI”
PËR SHOQËRINË “STONE ALB” SHPK.**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 25.3.2021, zhvilluar online, mbështetur në nenin në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, të Ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; Ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, Ligjin nr 10304/2010 “ Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” , VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” i ndryshuar me VKM nr 684/2020 ; Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 26.01.2017 “Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar” , VKM nr 1353 datë 10.10.2008 i ndryshuar “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar , VKM nr 1374 datë 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave, që ndiqen për heqjen , shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor” i ndryshuar , shkresës e Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit nr.583 prot., datë 17.01.2020 “Për dhënie dakortësie për heqjen nga fondi pyjor”, si dhe bazuar në relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

V E N D O S I:

1. Të miratojë dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor/kullosor publik për aktivitet minerar të shfrytëzimit të gurit gëlqeror për objektin Gajtan-Guri i Zi, të sipërfaqes totale prej 2.508 ha , prej të cilave 0.542 ha

ndodhur në ngastrën 60 dhe 1.966 ha ndodhur në ngastrën 63/b, ndodhur në Eknominë Pyjore “ PrueMos Sheldi”, të Bashkisë Shkodër.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR


Briseta KADIJA



Sekretari i Këshillit Bashkiak


Denis Lesha

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 26.3.2021